

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të dashur qytetarë shqiptarë dhe ju bashkëqytetarët e mi, banorë të Lezhës!

Jemi edhe sot në këtë seancë për të diskutuar buxhetin e vitit 2022. E për ta diskutuar në parim buxhetin duhet të përmendim fillimisht se cili është parimi mbi të cilin duhet të ndërtohet dhe të hartohet buxheti i shtetit. E pra nuk mund të ndërtohet buxheti as me hamendësime, as me dëshira dhe as me nevoja të ngushta të grupimit qeverisës. Së pari, duhet t'ia kujtojmë vetes sonë, pastaj edhe të tjerëve se, me sa duket, është harruar se buxheti i shtetit formohet nga taksat dhe tatimet e shqiptarëve, pra formalisht quhet buxhet i shtetit, por faktikisht është buxheti i popullit. Duhet t'ia kujtojmë vetes dhe të tjerëve se taksat dhe tatimet që i merren popullit burojnë nga puna e përditshme e njerëzve të ndershëm. Them njerëzit e ndershëm, sepse janë pikërisht ata që paguajnë kontributet për jetën e përbashkët. Dhe tragjedia e buxhetit është se paratë që merren si taksa nga puna e njerëzve të ndershëm përfundojnë në xhepat e njerëzve të pandershëm. Kjo është edhe tragjedi, se vjedhje po se po. Pse ndodh kjo? Pse ndodh kjo dalje dhe devijim i qeverisë nga detyrat e saj kushtetuese? Një devijim, në fakt, nga detyrimet kushtetuese të kësaj qeverie është edhe braktisja e sallës sot, kur po diskutohet pikërisht për buxhetin e vitit 2022, për buxhetin e familjeve shqiptare që do t'u japë zgjidhje halleve dhe problemeve të familjeve shqiptare. E pra, ndodh që të devijohesh edhe nga parimet kushtetuese, sepse tregojnë sa e thellë është mungesa e përgjegjësisë së kësaj qeverie Gjithashtu, ndodh, sepse buxheti që sot diskutohet në parim nuk ka asnjë parim mbi të cilin të mbështetet.

Parimi kryesor i një buxheti të vërtetë është që paratë që u merren njerëzve nga taksat dhe tatimet shteti duhet t'jua kthejë përsëri njerëzve si shërbime, si investime, si mbrojtje, si shëndetësi, si siguri dhe si arsim. E pra, kjo nuk po ndodh. Sot buxheti i shqiptarëve ndahet në PPP, në koncesione e në tenderë korruptivë. Edi Rama po e jep me koncesion mundin dhe djersën e shqiptarëve që punojnë dhe paguajnë taksa, nga ana tjetër, edhe ato para që përcaktohen për shëndetësi, për arsim, për siguri dhe për vepra publike as gjysma e tyre nuk shkojnë në destinacion, sepse zhduken nga zyrtarët e korruptuar, të cilët i ndajnë me njëri-tjetrin për të forcuar hajdutërinë, për të mbajtur gjallë militantizmin dhe partinë-shtet.

Pra, jemi në modelin ku një pjesë e buxhetit dërgohet në destinacionet e gabuara me politika të gabuara, ndërsa pjesa tjetër dërgohet në vendin e duhur, por zhduket nga korrupsioni. Çfarë mbetet këtu për shqiptarët? E pra, nuk mbetet asgjë, asnjë përmirësim i standardeve të jetesës. Kur na u vu në dispozicion tabela e të ardhurave dhe e shpenzimeve, tabela ku tregohet mënyra se si do të përdoren taksat e shqiptarëve, pyetja e parë që më lindi mua dhe besoj cilitdo prej jush ishte: Për kë punon kjo qeveri? Si është e mundur që në këtë buxhet fondi për ndihmën ekonomike për shtresat e varfra është vetëm 60 milionë euro, ndërkohë që shpenzimet për luksin qeveritar rriten me 71 milionë euro? Natyrshëm lind përsëri pyetja: për kë punon kjo qeveri? Kujt i shërben kjo qeveri? Mbi cilin parim e harton buxhetin kjo qeveri? E pra, e harton mbi parimin le të pasurohemi vetë, le të pasurohen shokët tanë, mbështetësit tanë, partia jonë, se shqiptarët janë mësuar të jetojnë në varfëri e nuk ju bën më përshtypje. Ky është parimi mbi të cilin Edi Rama e bazon buxhetin. Ju përmenda herën e kaluar në këtë parlament se në Lezhë ka vetëm një çerdhe dhe se mungesa e çerdheve është problem për shumë familje lezhjane. Kjo nuk i interesoi asnjë njeriu, as deputetëve të Lezhës që janë në këtë sallë, as ministrisë dhe as bashkisë, askush nuk u mor me këtë problem. Ju përmenda që ka varfëri, ka

papunësi të madhe, që Lezha është qarku me nivelin më të lartë të emigracionit për numër popullsie, ka pasiguri, ka vjedhje, ka kanabizim, ka zhvatje të përditshme të popullit nga administrata shtetërore, por asgjë nuk është adresuar në këtë buxhet për ta luftuar dhe për ta ndryshuar këtë realitet të trishtë fatkeqësisht. Keni 8 vjet në qeverisje duke hartuar buxhetet e shtetit. A mundeni të na thoni se çfarë bëtë ju për qarkun e Lezhës këto 8 vjet? Cilat janë veprat tuaja? A mundeni të ngriheni këtu dhe të na i numëroni, pastaj të na thoni nëse hartoni buxhet për vete, për xhepat tuaj apo për shqiptarët? Lexova tek tabela e investimeve se në këtë buxhet do të ketë financim për fasadat e pallateve të Lezhës. Shumë mirë, pa dyshim nuk jam kundër, por a mund të na thoni sa ndikon ky buxhet në performancën ekonomike të qarkut Lezhë? Sa parashikohet t'i rrisë të ardhurat dhe sa mendohet se do ta ulë papunësinë? Sepse buxhet pas buxheti, sipas shifrave tuaja të INSTAT-it, qarku i Lezhës vazhdon të mbetet një qark i varfër dhe me papunësi të lartë. Sa parashikohet rritja e prodhimit bujqësor? Verën që kaloi me dhjetëra fermerë janë ankuar për mungesë prodhimi për shkak të thatësisë së madhe, duke deklaruar se nuk kishin ujë për të vaditur, ndërsa disa të tjerë ankohen se nuk kanë ku t'i tregtojnë prodhimet bujqësore dhe blegtorale, por i gjejmë përgjatë gjithë autostradës nga mëngjesi deri në darkë në tentativë për të shitur diçka. Disa falimentuan e disa e quanin veten me fat nëse do të nxirrnin paratë e investuara pa fitim.

Pra, ky buxhet nuk parashikon asnjë sistem vadijeje për fushat e Torovicës, të Zadrimës, të komunës së Shënkollit e të Zejmenit. Pse nuk është parashikuar asgjë për t'u ardhur në ndihmë atyre banorëve? Nuk parashikohet, sepse paratë janë destinuar për të shkuar diku tjetër. A mundeni të na thoni sa e keni financimin për fermerët në qarkun Lezhë? E para, paratë e parashikuara për subvencion për fermerët janë shumë pak, as 30 milionë euro për gjithë Shqipërinë. E dyta, edhe ato pak para nuk mund të shkojnë dot tek fermerët, sepse ndahen për korrupsion nëpër drejtoritë e bujqësisë. Fermerit që do të ketë fatin të financohet, do t'i duhet të firmosë për të marrë të paktën gjysmën, sepse gjysmën tjetër duhet t'ua japë drejtorëve të korrumpuar, përndryshe nuk merr asgjë, e pra te fermeri në fund nuk shkon asgjë. Prandaj, po ju them se nuk ka parim politik dhe shtetëror në hartimin e këtij buxheti. A mund të më thoni: sa e ul papunësinë ky buxhet? Zero. Sepse nuk ka si qëllim punën. Me sa e rrit cilësinë e arsimit? Zero. Sepse sistemi arsimor nuk është në rëndësinë e kësaj qeverie. Sa e përmirëson shëndetësinë? Zero. Sepse nuk ka si qëllim shëndetin, por është buxheti i sëmundjes së korrupsionit. Sa e rrit sigurinë publike ky buxhet? Zero. Sepse nuk ka qëllim të luftojë krimin, përkundrazi në mënyrë të tërthortë, në mënyrën si shpërndahen këto para krimi i organizuar forcohet, sepse është pjesëmarrës në tepsinë e Ramës. Pra, Edi Rama nuk pranon të luftojë as krimin e organizuar, as të luftojë korrupsionin, as të hetojë zyrtarët e lartë dhe as sistemin e drejtësisë të pavarur nga qeveria, kjo, sepse çdo hap në këto drejtime është një kërcënim direkt që i bëhet pushtetit të tij të bazuar te krimi, korrupsioni dhe shitblerja e zgjedhjeve.

Të dashur qytetarë,

Ju nuk jeni dhe as nuk keni qenë ndonjëherë prioritet i kësaj qeverie, prandaj ky buxhet nuk do të ketë asnjë ndikim në ekonomi, as në uljen e papunësisë, as në shërbimin shëndetësor, as në cilësinë e arsimit dhe as në sigurinë publike. Atëherë çfarë mbetet? Si mund të konsiderohet ky buxhet? Na mbetet që ta konsiderojmë si mekanizëm të vjedhjes. Ky buxhet është arma me të cilën u merren paratë shqiptarëve dhe u shpërndahen njerëzve të Edi Ramës, kaq është e gjitha. Parimi tjetër është parimi i heshtjes. Deputetët socialistë i dinë mjaft mirë problematikën që kanë fshatrat dhe qytetet e mbarë Shqipërisë, por, edhe po të duan nuk mundin të kërkojnë investime. Nuk mundin, sepse e dinë mirë që Rama copat e mëdha i ka ndarë dhe i ka paracaktuar për rrethin e afërt dhe nervozohet me ta nëse i kërkojnë investime, sepse paratë e shqiptarëve i konsideron si paratë e veta. E pra, ky buxhet është një akt i pastër vjedhjeje. Prandaj është një turp i madh që ky parlament dhe kjo maxhorancë të miratojnë një akt me të cilin u vidhen miliona euro shqiptarëve. Faleminderit!

